UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 11 Prot. Durrës, më 06.01.2022

# VENDIM

**Nr 1, datë 06.01 2022**

## "Për miratimin paraprak të detajimit të grantit të vitit 2022, për Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës"

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", zbatim të ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit të përbashkët të MASR dhe MFE nr. 20, datë 20.09.2019, Vendimit nr. 58, datë 06.10.2021 të Senatit Akademik "Për miratimin paraprak të PBA 2022-2024", Vendimit nr. 69, datë 29.10.2021 të Bordit të Administrimit "Për miratimin e PBA 2022-2024", shkresës së ardhur nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit "Dërgohen fondet grant të miratuara sipas ligjit 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit Financiar, Senati Akademik,

**VENDOSI**:

1. Miratimin paraprak të detajimit të grantit të vitit 2022, për Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

**KRYETARI SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK
Adresa: Lagja 1, Rr "Currilave", Durres
Tel & Fax: 00355 52 39163 / 62
Website: www.uamd.edu.al

**TOTALI BUXHETIT UAMD 2022** **841,169,694**

## Granti per vitin 2022 (pakesime)

ne leke

| Kodi I Qeverisjes | Ministria e Linjes | Institucioni | Emri I Institucionit | Kapitulli | Programi | Llogaria Ekonomike | Kodi I Qarkut | Output kod | Emertimi i produktit | Buxheti i detajuar per vitin 2022,DEBIA ne lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0.01 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres | 1 | 9450 | 604 | 707 | 91105AA | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve | 765,029,694 |
| 0.01 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres | 1 | 9450 | 604 | 707 | 91105AB | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve | 76,140,000 |
| | TOTALI | | | | | | | | | 841,169,694 |

## Detajimi i grantit per vitin 2022( shtesa)

ne leke

| Kodi I Qeverisjes | Ministria e Linjes | Institucioni | Emri I Institucionit | Kapitulli | Programi | Llogaria Ekonomike | Kodi I Qarkut | Kodi I Produktit | Emertimi i produktit | Granti i detajuar per vitin 2022, Kredia ne lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0.01 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres | 8 | 9450 | 600 | 707 | 91105AA | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve | 610,029,694 |
| 0.01 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres | 8 | 9450 | 601 | 707 | 91105AA | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve | 95,000,000 |
| 0.01 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres | 8 | 9450 | 602 | 707 | 91105AA | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve | 60,000,000 |
| 0.01 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres | 8 | 9450 | 606 | 707 | 91105AB | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve | 76,140,000 |
| | TOTALI | | | | | | | | | 841,169,694 |

**KRYETAR**

**Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "ALEKSANDER MOISIU" DURRES

REPUBLIKA E SHQIPERISË

**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**
**ADMINISTRATORI**
**DREJTORIA E ADMINISRIMIT FINANCIAR**

# RELACION "PËR DETAJIMIN E FONDEVE TË MIRATUARA NË FORMËN E GRANTIT TË MËSIMDHËNIES, PËR VITIN 2022" PËR UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*, Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"; Ligjit Nr. 137/2020 "*Për Buxhetin e Vitit 2021*" ; Udhëzimit të përbashkët Nr.20 datë 20,09,2019 të MASR dhe MFE "*Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor*"; VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 "*Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor*" buxheti i miratuar në grupin e shpenzimeve korente (**Granti i mësimdhënies**) i akorduar nga MASR, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, për vitin 2022 është në vlerën totale **841 169 694 lekë** nga të cilat 765 029 694 lekë janë çelur në produktin "studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve" për shpenzime personeli dhe shpenzime operative për funksionimin dhe 76 140 000 lekë janë çelur në produktin "studentë që përfitojnë bursa financiare", paraqitur sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela nr. 1 Fondet e miratuara per vitin 2022**

**Buxheti Total 2022**

**841,169,694**

| Kodi Qeverisjes | Ministria e Linjes | Institucioni | Emri i Institucionit | Kapitulli | Programi | Llogaria Ekonomike | Kodi I Qarkut | Output kod | Emertimi I Produktit | Buxheti i detajuar per vitin 2022, DEBIA ne lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 001 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu" Durres | 01 | 09450 | 6040000 | 0707 | 91105AA | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve | **765,029,694** |
| 001 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu" Durres | 01 | 09450 | 6040000 | 0707 | 91105AB | Studentë që përfitojnë bursa financiare si dhe mbështetje financiare për akomodim ne shtepiat e trajtimit te studenteve | **76,140,000** |

Bazuar në Udhëzimin nr.20 datë 20,09,2019 të MASR dhe MFE "Granti i mësimdhënies (transferta e pakushtëzuar) e akorduar nga MASR, për vitin 2022 detajohet në shpenzime për paga, shpenzime për sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime për bursa.
Duke marrë në konsiderate shpenzimet e realizuara për vitin 2021, pritshmëritë për vitin 2022, kërkesat buxhetore të hartuara në PBA 2022-2024, kërkesat buxhetore të paraqitura nga Njësitë Kryesore dhe Drejtoritë, ropozimi mbi detajimin e grantit për vitin 2022 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme.

*Tabela nr. 2*

***Detajimi i grantit per vitin 2022( shtesa)***

ne leke

| Kodi I Qeverisjes | Ministria e Linjes | Institucioni | Emri I Institucionit | Kapitulli | Programi | Llogaria Ekonomike | Kodi I Qarkut | Kodi I Produktit | Emertimi i produktit | Granti i detajuar per vitin 2022, Kredia ne lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0.01 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres | 8 | 9450 | 600 | 707 | 91105AA | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve | 610,029,694 |
| 0.01 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres | 8 | 9450 | 601 | 707 | 91105AA | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve | 95,000,000 |
| 0.01 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres | 8 | 9450 | 602 | 707 | 91105AA | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve | 60,000,000 |
| 0.01 | 11 | 1011150 | Universiteti "Aleksander Moisiu", Durres | 8 | 9450 | 606 | 707 | 91105AB | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve | 76,140,000 |
| | **TOTALI 2022** | | | | | | | | | **841,169,694** |

- Në zërin "shpenzime për paga" art. 600 janë planifikuar 610,029,694 lekë ose 72.5 % e totalit të grantit. Në këtë zë janë përfshirë shpenzime për paga për personelin me kohë të plotë për 12 muaj të vitit 2022, shpenzime për orë suplementare për vitin akademik 2021-2022, shpenzime për pagesën e personelit akademik me kohë të pjesshme.
- Në zërin "shpenzime për sigurime shoqërore" janë planifikuar 95 000 000 lekë ose 11.3 % e grantit. Në këtë zë janë përfshirë shpenzime për sigurime shoqërore për personelin me kohë të plotë për 12 muaj dhe shpenzime për sigurime shoqërore për personelin me kohë të pjesshme.
- Në zërin "shpenzime operative" janë planifikuar 60 000 000 lekë ose 7 % e grantit Në këtë zë janë planifikuar shpenzime për funksionimin e Institucionit ku përfshihen furnizimi me energji, ujë, shërbimi postar, pagesa për akreditim, regjistrim dhe liçensim programesh, pagesa për anëtarë komisionesh, etj.
- Shpenzime për shpërndarjen e bursave (fondi i mbështetjes studentore) janë miratuar 76 140 000 lekë ose 9 % e grantit.

Planifikimi i shpenzimeve është realizuar duke marrë në konsideratë sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të Institucionit. Detajimi i grantit të vitit 2022 për artikull është në njëjtën masë me detajimin e grantit të vitit 2021. Pjesa më e madhe e grantit ose 83.8 % e tij është planifikuar për financimin shpenzimeve për personelin, si detyrimi primar i Institucionit. Qëllimi i këtij planifikimi është që shpenzimet për personelin të përballohen nga granti i vitit 2022 dhe të mos përdorim të ardhurat për këtë kategori shpenzimesh.

Për sa i përket shpenzimeve operative të planifikuara për t'u financuar nga buxheti, paraqiten në vlerën 60 000 000 lekë duke iu referuar shpenzimeve të realizuara me financim nga buxheti gjatë vitit 2021 si dhe PBA 20222-2024. Sqarojmë edhe një herë se ky fond do të përdoret për likujdimin e shpenzimeve të domosdoshme për funksionimin normal të Institucionit.

Në lidhje me fondin e planifikuar për shpenzime për bursa (fondi i mbështetjes studentore), është planifikuar në vlerën 76 140 000 lekë sipas fondit të miratuar dhe përcjellë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Me këtë fond do të trajtohen me bursë rreth 846 studentë të ciklit të parë.

**HARTOI**

**Drejtor i Drejtorisë së Administrimit Financiar**

**Etleva Laçi**